



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:057274  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05576540

**C.nr.1443/20**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari G. A, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. K. e S. (B.), me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit K. ( S. ) Ç. nga Gjilani , Rr.”M. I. Gjilan” nr.227, me objekt kontesti për rimbursim të dëmit material dhe jomaterial, pas mbajtjes së seancës me datën 15.04.2024, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. Konsiderohet** e tërhequr, padia e paditëses B. K. e S. (B.), me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit K. ( S. ) Ç. nga Gjilani , Rr.”M. I. Gjilan” nr.227 me objekt kontesti për rimbursim të dëmit material dhe jomaterial.

**II.** Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi Lënda C.nr. 1443/20, konsiderohet e kryer dhe arkivohet nga Gjykata Themelore në Gjilan. Për zgjidhjen e çështjes jokontestuese, në rast se krijohen kushtet ligjore, paditësja mund të ushtroj padi të re, në kopje të mjaftuara, përmes kësaj gjykate.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditësja B. K. e S. (B.), me seli në Prishtinë, e ushtuar me datën 26.05.2020, me objekt kontesti për rimbursim të dëmit material dhe jomaterial.

Lidhur me këtë çështje, gjykata me datën 15.04.2024, ka caktuar seancë përgaditore dhe në këtë seancë kanë munguar përfaqësuesi i paditëses, si dhe i padituri edhe pse ishin ftuar në mënyrë të rregullt, mosardhjen nuk e kishin arsyetuar.

Andaj, gjykata ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses, konform nenit 409 dhe 102 të LPK-së, në të cilin nen shprehimisht parashihet se “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.*”, e që në rastin konkret pala paditëse ka munguar në seancë edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt, mosardhjen nuk e kishte arsyetuar, gjithashtu edhe pala e paditur kishte munguar, andaj gjykata e pati të pamundur që të merr kërkesën e tyre, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për shpenzimet e procedurës gjyqësore, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, bazuar në nenin 142 dhe 409 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN –Divizioni Civil**  
**C.nr.1443/2020, datë 15.04.2024**

**Gjyqtari:**

**G.A**

**Udhëzim mbi Mjetin Juridik:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë pas pranimi të këtij vendimi, përmes kësaj gjykate, në ekzemplarë të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.